



Ky hulumtim është përkrahur
nga Zyra e Karrierës

Hulumtim

NDIKIMI I DIXHITALIZIMIT NË MËSIMNXËNIE

Lënda: Metodologjia e Hulumtimit
Departamenti: Shkenca Politike

Studentët:
Arnesa Tahiri
Besarta Verbovci
Fatbardha Raçi

Mentor:
Alisa Hasani

Maj 2018



Kolegji Universum

DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE SHKENCORE

Autor:

Arnesa Tahiri
Besarta Verbovci
Fatbardha Raçi

Botues:

Departamenti i Kërkimeve Shkencore
Instituti për Studime Ekonomike dhe Sociale
Kolegji Universum

Këshilli Editorial:

Alisa Hasani
Arlinda Berisha
Uran Rraci
Uresa Vllasa

NDIKIMI I DIXHITALIZIMIT NË MËSIMNXËNIE

Abstrakt

Dixhitalizmi i mësimit në shkolla është një koncept relativisht i ri. Megjithatë, disa pyetje ende mbetet të papërgjegjura: ç'do të thotë të dixhitalizosh arsimin? Si përkthehet kjo në terma praktik? A ka në të vërtetë dixhitalizimi ndikim në të arriturat e nxënësve? Andaj ku hulumtim është munduar t'i përgjegjet disa nga këto pyetje dhe sugjeron që dixhitalizimi ka ndikim në mësimit në nxënësve.

Hyrje

Ditëve të sotme përdorimi i mjeteve dixhitale është bërë i pashmangshëm. Teknologjia dhe mjetet dixhitale e kanë thjetëzuar jetën e njeriut, Tashmë mjetet dixhitale përdoren gjithandej në mënyra të ndryshme duke përfshirë shkollat, kolegjet dhe fakultetet. Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimit dhe mësimit, nënkupton përdorimin e kompjuterëve dhe softëare-ve në mënyrë produktive, shfrytëzimin e internetit dhe përdorimin e rrjeteve kompjuterike për qëllime të mësimit dhe të nxënësve . Përdorimi i TIK–ut në të gjitha proceset jetësore është kthyer në një domosdoshmëri jetike në mbarë botën, Si në çdo fushë të jetës, edhe në arsim, TIK-u ka sjellë një kthesë rrënjësore në zhvillimin e kulturës së të nxënësve të mësimit, duke i bërë njohuritë më të qasshme për të gjithë nxënësit. Në dritën e revolucionit të vazhdueshëm dixhital në edukim dhe mësimit si dhe në mësimit në veçanti, qëllimi i këtij hulumtimi është vlerësimi i kualitetit të mësimit me mjete dixhitale - kompjutere, aplikacione dixhitale të ndryshme, në krahasim me metodat tradicionale të mësimit. Ne kemi identifikuar një numër relativisht të vogël studimesh që mund të kategorizohen si studime cilësore duke përdorur një dizajn të studimit të rastit ose dizajn brenda lëndës dhe si studime sasimore,ose studime pothuajse eksperimentale ose kohorte; në rezultatet e të cilave do të mund të bazoheshim.

Metodologjia

Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur eksperimenti dhe intervistat - triangulimi. Eksperimenti u realizu në dy grupe të studentëve të kolegjit Universum:

- grupi i studentëve të Shkencave Politikë, viti i parë, të universum, në kampusin e Prishtinës dhe
- grupi i studentëve të departamentit të Biznes Menaxhment, viti i parë, kampusi Ferizaj.

Eksperiment 1, grupi 1:

Eksperimenti u realizu gjate ligjeratës në Metoda Hulumtuese në kampusin e Prishtinës. Studentët dëgjuan ligjeratën në këtë lëndë për pyetësoret, pa u përdorur asnje metode dixhitale e spjegimit; madje as poëerpoint nuk kishte. Studentët pas ligjeratës plotësuan tre pyetje rreth ligjeratës, për të parë se sa e kanë kuptuar atë.

Eksperimenti 1, grupi 2:

Eksperimenti u realizu gjate ligjeratës në Metoda Hulumtuese në kampusin e Ferizajit. Studentët dëgjuan ligjeratën në këtë lëndë për pyetësoret, ku u përdor vetëm poëerpointit. Studentët pas ligjeratës plotësuan tre pyetje rreth ligjeratës, për të parë se sa e kanë kuptuar atë.

Eksperiment 2, grupi 1:

Eksperimenti u realizu gjate ligjeratës në Metoda Hulumtuese në kampusin e Prishtinës. Studentët dëgjuan ligjeratën në këtë lëndë për intervistat, ku gjatë ligjeratës u përdorën forma të ndryshme vizuale, si poëerpoint dhe video me intervista, ku me pas u bë një ushtrim duke u bazuar në këto video. Studentët pas ligjeratës plotësuan tre pyetje rreth ligjeratës, për të parë se sa e kanë kuptuar atë.

Eksperiment 2, grupi 1:

Eksperimenti u realizu gjate ligjeratës në Metoda Hulumtuese në kampusin e Ferizajit. Studentët dëgjuan ligjeratën në këtë lëndë për intervistat, ku gjatë ligjeratës u përdorën forma të ndryshme vizuale, si poëerpoint dhe video me intervista, ku me pas u bë një ushtrim duke u bazuar në këto video. Studentët pas ligjeratës plotësuan tre pyetje rreth ligjeratës, për të parë se sa e kanë kuptuar atë.

Për të parë se si ndikojnë mjetet dixhitale në mësim nxenie, u krijua një indeks nga tri pyetjet rreth njohurive për secilën ligjeratë. Me pas u nxorr mesatarja (mean), e indeksit të secilit grup për secilën ligjeratë. Me pas, mesatarja u krahasua ndër grupe dhe ndër ligjeratë. Për më tepër, mesatarja u krostabulua (crosstabulate) me notën mesatare për të parë nese nota mesatare e studentëve ka ndikim në pergjegjet e tyre.

Për më tepër, si metodë tjetër për mbledhje të të dhënave u përdor edhe intervistimi, me c'rast u realizuan 4 intervista me studentë të kolegjit Universum. Mostrimi për intervista ka qenë joprobabilitar, aksidental.. Secilit student i janë parashtruar tre pyetje të hapura të cilat janë incizuar për transkriptim.

Përfundime:

Rezultatet qartazi tregojnë që me inkuadrim e mjeteve dixhitale në mësimdhënie, mësimnxenie është cilësisht me e lartë. Figura 1, tregon mesataren e krijuar nga indeksi i njohurisë së studentëve të grupit të parë, kur ligjerimi bëhet në mënyrë tradicionale, pa përdorim të ndonjë metode dixhitale. Mesatarja është 2.3 nga 5. Kur kjo mesatare krahasohet me grupin e dytë, të cilët janë një set i studentëve të njejte, të cilët i nënshtrohen ligjeratës së njejtë, por në të cilën përdoret prezentimi vizual, atehere mesatarja e njohurise për këtë grup eshte 3, nga 5 (Figura2). Pra ka rritje për 0.7. Për të kontrolluar ndikim e variablave tjera, mesatarja për të dy grupet shikohet, nëse nota mesatare është me e lartë se 7.5 dhe shihet se mesatarja rritet per .2; por kjo rritje shihet tek te dyja grupet.

	Mean	Std. Err.	[95% Conf.	Interval]
kn_index	2.333333	0.3296088	1.587706	3.07896

Fig1. Indeksi i njohurise, Eksperimenti 1, grupi 1

	Mean	Std. Err.	[95% Conf.	Interval]
kn_index	3	0.3333333	1.565782	4.434217

Figura 2. Eksperimenti 1, grupi 2.

Ndërkaq, i njëjti rezultat vërehet edhe në eksperimentin e dytë, ku të dyja grupet testohen pas prezentimit të stimulit (metodave dixhitale). Pra, në këtë eksperiment, të dyja grupet shërbejnë si grupe eksperimentale dhe rezultatet janë krahasuar mes tyre dhe mes eksperimentit të parë dhe grupit të parë, që ishte grup i kontrollit. Figura 3, tregon mesataren e indeksit të njohurisë, për grupin 1, pasi që nënshtrohen në një ligjërata ku përdoret prezentimi vizual, video dhe diskutim mbi video; dhe shihet që mesatarja rritet me 0.3. Njëkohësisht, indeksi i njohurisë për grupin 2, pas eksperimentit 2, rritet për 0.3, ku vlera e saj arrin në 3.3.

	Mean	Std. Err.	[95% Conf.	Interval]
kn_index	2.666667	0.3121016	1.660644	3.07269

Figura 3. Eksperimenti 2, grupi 2.

Kur krahasohet grupi i kontrollit mes veti, shihet që ka rritje të mësimnxeniës, pasi që studentët i nënshtrohen formave të ndryshme dixhitale të ligjerimit (Eksperiment 1, grupi 1, krahasuar me eksperimentin2, grupi 1). Rritje ka edhe kur krahasohet grupi i kontrollit me grupin eksperimental. (Eksperimenti 1, grupi 1 me eksperimentin1, grupi 2).

Për të verifikuar këto rezultate, janë realizuar intervista me 4 studentë të kolegjit Universum. Nga 4 studentë të intervistuar, të cilët u zgjodhën në mënyrë aksidentale, dy prej tyre e përkrahnin fuqishëm dixhitalizimin nëpër shkolla dhe universitete dhe dy prej tyre nuk ishin përkrahës të mjeteve teknologjike nëpër shkolla dhe universitete.

Arsyet për të cilat studentët përkrahnin dixhitalizimin dhe e shihnin të nevojshëm nëpër shkolla/universitete sipas tyre ishin:

- Është më e lehtë të bartësh një tablet me të gjitha informatat përbrenda sesa të bartësh

- numër të madhë të fletoreve dhe librave (duke marr parasysh se shumë fëmijë ankohen
- nga çantat e rënda të cilat shkaktojnë dhimbje shpine).
- Mësimnxënia nga largësia është më e lehtë nëpërmjet internetit ku të gjitha ligjëratat
- vendosen në internet dhe mund të ketë çasje çdo student edhe nëse nuk ka pas mundësi t'i
- vijoj ligjëratat.
- Ligjëratat do ishin më atraktive dhe efikase për studentët duke i'u tërhequr më shumë
- vëmendjen e tyre.
- Mos-dixhitalizimi i njërit nga institucionet e larta publike ka ndikuar që të humbet
- interesimi i vazhdimt të studimeve nga njëri nga studentët e intervistuar.

Arsyet për të cilat studentët nuk përkrahin dixhitalizimin dhe e shihnin të panevojshme në shkolla/universitete sipas tyre ishin:

- Nuk mendojnë që dixhitalizimi e bën më atraktive ligjëratën dhe sipas tyre më mirë është studentët të shprehin vet atë çka e mendojnë dhe nuk kushtëzon zhvillimin e ndonjë çështje të caktuar si psh ligjëratën.
- Për shkak të kostos së lartë mendojnë që nuk i'a vlen të investohen në dixhitalizim të institucioneve arsimore, por të investohet në disa sfera tjera që sipas tyre janë më primare dhe më të rëndësishme.

Nga të dhënat e marra nga intervistat shihet se ndikimi i dixhitalizimit në suksesin e studentëve ka qenë i ndryshëm. Studentët të cilët nuk e kanë përkrahur dixhitalizimin janë shprehur që dixhitalizimi nuk ka pasur asnjë ndikim në studimet e tyre ata vetëm kanë vazhduar ritmin e të mësuarit njësoj siç kanë qenë në shkollë fillore dhe shkollë të mesme, Ndërsa studentët që përkrahin dixhitalizimin mendonin që ajo ka ndikuar shumë në të arriturat e studimeve duke e rritur kështu interesimin për të vijuar ligjëratat; gjë që ka ndikuar pozitivisht edhe në performancën e tyre në provime.

Rekomandime:

Marrë parasysh rëndësinë e kësaj teme, dhe limitimeve që ka mund t'i këtë ky hulumtim, sugjerohet që një hulumtim i ardhshëm të bëhet në kete fushe duke marrë për bazë një mostër më representative: dukë përfshire më shumë nxënes dhe eksperimentin në më shumë klasa dhe lëndë.

Përdorimi i platformave dixhitale është i kushtueshëm gjë që për ekonomin e vendit tonë është goxha problematike; ne sugjerojmë që të bëhet një analize cost-benefit, që të shihet cilat janë avantazhet/disantazhet dhe nese benefitet janë më të shumta sesa kostoja.

Për për teper, duke ditur që kostoja e lartë e sistemeve dixhitale i marxhinalizon shkollat në zonat e varfra dhe shkollat rurale, kjo sjell diskriminim dhe krijon ndarësi “dixhitale” duke e rritur hendekun mes dy grupeve. Andaj, një vemendje më e larte i duhet kushtuar kësaj.

Duke marrë parasysh hulumtimet që litetura sugjeron që që qasja për një arsim dixhital përveç qëllimit të mirë duhet të jetë multidimensional dhe multisektorial – duhet të jetë një qasje që kombinon përdorimin e përgjegjshëm të pajisjeve dixhitale me diturinë e koncepteve themelore dixhitale si dhe reflektimet tona shkencore, etike dhe filozofike.

REFERENCA:

- [1] Technology can close achievement gaps, improve learning(2014).Marrë nga School of Education Statford:
<https://ed.stanford.edu/news/technology-can-close-achievement-gaps-and-improve-learning-outcomes>
- [2] Technology can hurt students' learning, research shows(2018).Marrw nga The Irish Times:
<https://www.irishtimes.com/news/education/technology-can-hurt-students-learning-research-shows-1.3385864>
- [3] Technology in Schools(2016).Hulumtimi i marrë nga Cisco Systems:
https://www.cisco.com/c/dam/en_us/solutions/industries/docs/education/TechnologyinSchoolsReport.pdf
- [4] Le numérique, un facteur d'ouverture de l'école à son territoire et à son environnement(2015).Debat marrë nga Ministria Francese e Arsimit:
<https://forum.ecolenumerique.education.gouv.fr/debat/le-num%C3%A9rique-un-facteur-d%E2%80%99ouverture-de-l%E2%80%99%C3%A9cole-%C3%A0-son-territoire-et-%C3%A0-son-environnement-0>

Kolegji Universum është institucion i arsimit të lartë, i akredituar pa kusht nga Agjencia për Akreditim e Kosovës. Programet e studimit, menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë janë vlerësuar shumë lartë nga ekspertët ndërkombëtarë (shih raportet e akreditimit).

Universum në partneritet me programin Erasmus+ të financuar nga Bashkimi Evropian, ka dërguar për studime jashtë vendit 47 studentë në 44 Universitete Ndërkombëtare të Evropës.

Universum ka partneritetet më të fuqishme ndërkombëtare nga të gjitha institucionet që veprojnë në Kosovë. Është i binjakëzuar me Chichester College (Angli), anëtarësuar në Global College Network, Anglia Network Europe, European Higher Education Society dhe ka mëse 30 institucione partnere nga e gjithë bota.

Universum është renditur në Top 1000 Shkollat më të mira të biznesit në Botë nga Eduniversal, si i vetmi institucion nga Kosova.

PRISHTINË

Ulpiana Kampus
Rr.Nik Prelaj, Objekti i "Beni Dones"
Tel. +381 38 555 315
Mob. + 377 44 144 062, 44 168 531
Skype: universum.college

FERIZAJ

Rr.Fan Noli, Nr.156
Tel. +381 290 324 596
Mob. + 377 44 354 034
Skype: universum-ferizaj

GJAKOVË

Rr.UÇK-së, përball pallatit të kulturës
Tel. +381 0390- 330990
Mob. + 377 44 750 858
Skype: universum-gjakova